



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr. Serial 000091

LEJE
PËR SHFRYTËZIMIN E MATERIALEVE INERTE

Nr.Prot. 15, datë 04/04/2023

Miraturar me:

VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR MAT

Nr.11, datë 28/03/2023

Emri i individit/subjektit: "4 A-M" SH.P.K
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/ NIPT): K92005016L
Baseni Ujor: MAT
Qarku: LEZHË
Bashkia/ Njësia administrative: LEZHË DHE MIRDITË
Koordinatat:

Zona 1: Lumi Fan

Pika 1	X1=479910.8;	Y1=4618698.8;	Z1=16 m.m.n.d
Pika 2	X2=479916.6;	Y2=4618548.9;	Z2=17 m.m.n.d
Pika 3	X3=478969.7;	Y3=4618886.9;	Z3=18 m.m.n.d
Pika 4	X4=478824.6;	Y4=4618920.2;	Z4=19 m.m.n.d
Pika 5	X4=478966.0;	Y4=4619036.5;	Z4=21 m.m.n.d
Pika 6	X4=479350.4;	Y4=4618962.5;	Z4=20 m.m.n.d

Zona 2: Lumi Mat

Pika 1	X1=481652.7;	Y1=4621195.9;	Z1=29 m.m.n.d
Pika 2	X2=481326.4;	Y2=4621222.1;	Z2=28 m.m.n.d
Pika 3	X3=481753.2;	Y3=4621929.0;	Z3=24 m.m.n.d
Pika 4	X4=481479.9;	Y4=4621929.0;	Z4=25 m.m.n.d

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret materiali inert: Për zbatimin e kontratës "Ndërtimi i segmentit rrugor Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri-Loti 2"
Sipërfaqja e shfrytëzimit: 426,181.81 m²

Volumi i materialit që do të merret: 120,000 m³/në vit

Volumi i materialit që do të më rret deri në pë rfundim të lejes: 120,000 m³

Vendi i shkarkimit të ujrave të përdorura (Koordinatat KRGJSH): nuk ka

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka): Sipas kushteve të Lejes dhe Vendimit bashkëngjitur

Periudha e vlefshmërisë: Sipas garfikut të punimeve, por jo më shumë se 3 vjet

Hyrja në fuqi: Pas publikimit në regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve

KRYETARI
GJERGJ PRËNDI



Kushtet e posaçme të lejes për shfrytëzimin e materialeve inerte

1. Të ushtrojë veprimtarinë në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me veprimtarinë;
3. Të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
4. Të regjistrojë vëllimin e materialit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer;
5. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit dhe të materialeve inerte sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
6. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
7. Të respektohen kushtet higjieno – sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit;
8. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujor;
9. Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të burimit ujor;
10. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
11. Të lejojë rrjedhën ekologjike;
12. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujor ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
13. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujor në gjendjen e mëparshme;
14. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
15. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për të mundësuar përdorimin e burimit ujor nga subjekte të tjerë;
16. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera për veprimtarinë të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore.